



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



Federata e Basketbollit  
të Kosovës  
+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Nr. 83  
Str: Radovan Zogovic  
10 000 Prishtina

**Prishtinë, 15/10/2024**

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 15.10.2024, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

## VENDIM NR. 15/2024/25 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I.** Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga KB Peja për regjistrimin e lojtarit Dardan Berisha si lojtar të lirë (free agent)<sup>1</sup> jashtë afatit kalimtar.
- II.** Komisioni i garave pas shqyrtimit të kësaj kërkeje e bazuar në Rregulloren për regjistrim dhe kalim të FBK-ës 2024/2025, MIRATON kërkesën e KB Peja.
- III.** Vendimi hyn në fuqi nga data e publikimit

<sup>1</sup> **Lojtar i lirë (free agent)** – lojtar të cilit i ka përfunduar kontrata me ekipin e tij të mëparshëm (nuk ka kontratë aktive/valide) dhe është i lirë të nënshkruajë një kontratë të re me cilindo ekip tjetër. Një lojtar i lirë ka të drejtë të negociojë dhe të pranojë oferta nga ekipet e tjera pa kufizime të vendosura nga ekipi i tij i mëparshëm.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



Federata e Basketbollit  
të Kosovës  
+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Nr. 83  
Str: Radovan Zogovic  
10 000 Prishtina

## ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur me Vendimin Nr. 15/2024-25, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- KB Peja ka paraqit kërkesë për regjistrimin e lojtarit Dardan Berisha si **lojtar të lirë (free agent) jashtë afatit kalimtar.**
- Lidhur me kërkesën e KB Peja, nga shkresat e prezantuara shihet se i njëjti e ka statusin e lojtarit të lirë, andaj në përputhje me nenin 14 pika 4.7 në Rregulloren për regjistrim dhe kalim të FBK-ës 2024/2025, u miratua ky regjistrim i lojtarit Dardan Berisha.

Në emër të Komisionit të Garave të FBK-së,

Armend **HAMITI**  
Kryetar i Komisionit



Federata e Basketbollit të Kosovës

### ***KËSHILLË JURIDIKE:***

*Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2024/2025, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.*

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters: